



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports
Kabineti i Ministrit
Kabinet Ministra
Minister's Office

Nr.62/2022
Datë: 19.05.2022

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Hajrulla Çeku, në mbështetje të nenit 145 (pika 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenin 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L – 113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/01 mars 2019), bazuar në nenin 8 (paragrafi 1.4) nenin 14 (paragrafi 1 nen paragrafi 1,8) të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në zbatim të nenit 32 të Ligjit Nr.04/L-075 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.2003/24 për Sport, në pajtim me Udhëzimin Administrativ Nr.02/2015 për Themelimin dhe Licencimin e Federatave dhe Shoqërive Sportive, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Nuk i vazhdohet vlefshmëria e licencimit të Federatës së Taekwondo të Kosovës.
2. Pezullohen përkohësisht efektet e Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
3. Deri në një vendim tjetër, sportistët e këtij sporti do të jenë në mbikëqyrjen e Komitetit Olimpik të Kosovës.
4. Obligohet Departamenti i Sportit të sigurojë të gjithë dokumentacionin përkatës që bën të mundur shqyrtimin dhe konstatimin e plotë të rrethanave të zgjedhjes dhe emërimit të organeve drejtuese të Federatës së Taekwondo'së së Kosovës, nga data 11.04.2018 e më tutje.
5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Pas nënshkrimit të Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) dhe Federatës së Taekwondo'së së Kosovës, MKRS, ka pranuar ankesë nga palë të tjera me pretendimin se të njëjtit, janë persona legjitim që përfaqësojnë autorizimet dhe të drejtat që rrjedhin nga licenca e autoritetit publik (MKRS –së) për degën e caktuar sportive, gjegjësisht sportin e taekwondo'së. Pas shqyrtimit të këtyre pretendimeve, MKRS ka vërejtur se ekzistojnë dokumente që në vitin 2018, viti kur për herë të fundit është lëshuar një licencë valide nga ministri i MKRS –së, si autoriteti kompetent i vetëm të cilit legjislacioni sportiv i njeh të drejtën dhe kompetencën për dhënien e licencës për një federatë sportive, qartësohet se janë dy persona përgjegjës që e përfaqësojnë këtë federatë në funksionet kryetar i FTK –së përkatësisht, sekretar i përgjithshëm i FTK –së.

MKRS ka filluar shqyrtim administrativ për të konstatuar me prova dokumentare mënyrën se si ka rrjedhur procesi i transferimit të përgjegjësi, gjegjësisht të drejtave dhe obligimeve që rrjedhin nga autorizimi i licencës në FTK, në kuptimin e zgjedhjes së organeve drejtuese në FTK, për të vërtetuar më pas legjitimitetin dhe legalitetin e palëve që përfaqësojnë autorizimet që rrjedhin nga licenca.

Duke qenë se licenca është mjeti përmes së cilës MKRS, në përputhje me Ligjin për Sportin, siguron financimin dhe delegimin ekskluziv për organizimin e një dege të caktuar sportive, si dhe duke u bazuar në faktin se Memorandumi i Bashkëpunimit, edhe me vet dispozitat e tij, kushtëzohet nga licenca e FTK –së, me qëllim që të sigurohet qartësi e veprimit administrativ dhe e alokimit të resurseve financiare në përputhje me interesin publik dhe në tërësi brenda dispozitave ligjore, deri në përfundimin e shqyrtimit të plotë të dokumentacionit dhe vërtetimit të saktë të gjendjes faktike dhe provave të cilat mundësojnë sqarim shterues të paqartësive ligjore, Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, vendosë si në dispozitiv të këtij akti administrativ.

Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komitetit Olimpik të Kosovës;
- Federatës së Taekwondo;
- Departamentit të Sportit;
- Departamentit Ligjor;
- Arkivit të MKRS-së.

